

# **Akt themelimi i Shoqerise me Kapital te Kufizuar**

## **“ Radio Klea” Sh.p.k**

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit” , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per shoqerite tregatre” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tyre te lire , te shprehur edhe me nenshkrimin e ketij akt-themelimi: Individi me pergjegjesi te kufizuar, banues ne Elbasan, krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “**Radio Klea**” Sh.p.k me akt themelimi si vijon :

### **Neni 1**

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur “**Radio Klea**” Sh.p.k .

Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues .

### **Neni 2**

#### **Selia e Shoqerise**

Selia e shoqerise tregtare private “Radio Klea Sh.p.k eshte ne adresen: Lagja “11Nentori, Rr28Nentori, Ndertesa 70, Hyrja 15, Apartamenti 28” Elbasan – Shqiperi

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoj filiale si brenda , ashtu dhe jasht Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem

### **Neni 3**

#### **Objektivi i Veprimtarise**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e transmetimeve audiovizive

Shoqeria ka te drejte te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

### **Neni 4**

#### **Kohezgjatja e Shoqerise**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat mbi 10-vjet. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkakut .

### **Neni 5**

#### **Kapitali i Shoqerise**

Kapitali fillestar i shoqerise private Radio Klea Sh.p.k do te jete “2 500 000” leke.

Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakut te vetem , e ndare ne 1 (nje) kuote .

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet ( por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar)

## Neni 6

### Drejtimi i Shoqerise

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj , ortaku i vetem dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj . Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme .

## Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem .

## Neni 8

Ortaku i vetem themelues ka te drejte te emeruje dhe administratore te tjere te vlerave materiale Ka te drejte te caktoje financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake .

## Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Elbasan.

## Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me logon e saj .

## Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Krijimin e Shoqerive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjom shoqeri .

## Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t’ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise “**Radio Klea**” **Sh.p.k**  
Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem .

Ortaku i vetem themelues  
i Shoqersie “Radio Klea Shpk “

Taulant Pilavi

Elbasan dt 10 - 09 - 2018